

ABORTET NË SHQIPËRI **ANALIZË E SISTEMIT TË SURVEJANCËS SË ABORTIT**

Çdo vit, Instituti i Shëndetit Publik mbledh të dhëna lidhur me abortet nga 34 qendra raportimi publike (maternitete të rretheve), si dhe nga gjithë institucionet private të licensuara për ndërprerje shtatzënie, në bazë të Urdhërit të Ministrit dalë në vitin 2007. Maternitetet e rretheve Kuçovë, Mallakastër dhe Malësi e Madhe nuk kryejnë ndërprerje shtatzënie. Qendrat e raportimit japin informacion nëpërmjet Inspektorëve të Shëndetit Publik në Drejtoritë e Shëndetit Publik të rretheve përkatëse. Të dhënat e Censurit (INSTAT) dhe ato mbi lindshmërinë (Ministria e Shëndetësisë) përdoren për llogaritjen e nivelit të abortit (aborte për 1.000 gra të moshës 15-44 vjeç) dhe raportit të abortit (aborte për 1.000 lindje të gjalla).

Në tabelën që vijon paraqitet indikator i aborte për 1000 lindje të gjalla, indikator i cili është paraqitur për periudhën 2011-2014.

Tabela 1: Aborte për 1000 lindje të gjalla sipas prefekturave, periudha 2010-2015

Prefekturat	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
Berat	258.8	461.1	272.7	358.1	298.2	218.4
Dibër	131.6	100.2	119.4	185.2	203.1	260.6
Durrës	164.8	148.1	179.4	140.7	154.2	164.7
Elbasan	67.6	70.4	68.6	70.8	86.7	107.1
Fier	298.7	262.0	279.4	244.6	207.8	207.7
Gjirokastrë	263.1	261.4	182	193.5	165.5	247.3
Korçë	200.3	176.5	202.3	133.8	148.3	119.3
Kukës	76.7	68.5	59.5	76.2	63.5	89.1
Lezhë	267.2	123.8	152.4	114.6	177.2	179.9
Shkodër	90.3	107.0	96.7	114.7	91.3	116.4
Tiranë	328.5	342.6	315.3	248.6	188.9	237.1
Vlorë	400.3	458.1	317.6	296.8	363.2	334.0
Total	238.8	242.2	224.3	195.3	177.1	199.0

Proportioni i abortit (aborte për 1000 lindje të gjalla) në shkallë vendi ka pësuar ulje, duke shkuar në 199,0 për vitin 2015 krahasuar me 238,8 që ka qenë në vitin 2010.

Tabela 2: Abortet sipas llojit (ndërprerje dhe abort spontan), periudha 2010-2015

Aborte në %	v. 2010	v. 2011	v. 2012	v. 2013	v. 2014	v. 2015
Ndërprerje	40	36.5	34.4	32.8	28.5	24.4
Abort spontan	60	63.5	65.6	67.2	71.5	75.6

Tabela 3: Abortet në përqindje ndaj totalit sipas vendbanimit të gruas

Vendbanimi	y. 2010	y. 2011	y. 2012	y. 2013	y. 2014	y. 2015
Urban	68,6	64,9	65,1	61,2	57,5	56,1
Rural	31,4	35,1	34,9	38,8	42,5	43,9

Alba Merdani

Koordinatore Kombëtare

Sistemi i Survejancës së Abortit

Instituti i Shëndetit Publik